



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 08.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Asfalti SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut “, Nr. i prokurimit- 632-23-2174-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Asfalti SH.P.K e dt.08.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut “, Nr. i prokurimit- 632-23-2174-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-023 - 521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 24.04.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m


Me dt.08.05.2023, Operatori Ekonomik Asfalti SH.P.K, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut “, Nr. i prokurimit- 632-23-2174-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-023 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.05.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë, është i pa bazuar sepse kriteri i dhënjes ka qenë çmimi ekonomikisht më i favorshëm e jo çmimi më i lirë siç pretendoni ju:

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 <input checked="" type="checkbox"/>
--------------------	------	--

Pretendimi juaj lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional nuk qëndron sepse OE "REA" sh.p.k., :
 - Për ing.ndert. Nysret Kastrati pretendimi juaj është i pabazuar, sepse OE "REA" sh.p.k., ka paraqitur Diplomën,CV dhe kontratën e punës:





REPUBLIKA E KOSOVES
NOTER
YLLI S. MEKAJ
PEJE

VERTETIM I FOTOKOPJES NGA DOKUMENTI ORIGINAL

LRP nr. leodor 4162/2019

NOTER Ylli Meka, noter në Pejë, me sili në z. "General Wesley Clark" nr.10, me datë shtatë maj
dy mijë e njëmbëdhjetë, më kërkesh e
Z. Nysret Kasprati, lindur me 10.08.1972 në Pejë, shtetas i Kosovës, u identifikua nga kërkuesitimi me
nr. ID1192647 dhe me id. nr. 2009809207 Meshuar nga MPB/RKS me tërësi veprimi.

VERTETON se:

Kopja e vertetur është identike mi kopjen e vertetur të sjellë nga pala.

Fotokopja u bë në zyrën notariale.

Dokumenti ka një foto dhe një lajë dhe vertetohet në tri kopje.

Pala deklaron se dokumenti nuk është nxjerrë në mënyrë të kundërgjishme dhe i njëjti u njohua për pasqyrt n
deklarimit të mirë.

Shërbimet notariale paguhën në bazë të UA 02/2012, tarifat e përshlyeme entetate sipas nenet 27.

Në zyrën notariale në Pejë, z. "General Wesley Clark" nr.10.



C.V.

TE DHENAT PERSONALE

Emri / Mbiemri **NYSRET KASTRATI**
Adresa **PEJË**
Telefoni
Fax
E-mail

Shtetesia **Kosovare**
Data lindjes **10.08.1977**

SHKOLLIMI

Shkoll fillore **Pejë**
Shkolla e mesme **Pejë**
Unevirsiteti **Fakulteti teknik, Prishtinë, Dega ndertimtarise**

AFTESI DHE NJOHURI PERSONALE **Gjuha Angleze Shkrim dhe Lexim (te pjeserishme)**

Te perfluara gjate jates edhe pa deshmi aftesie.

**Kurs te Kompjuterave 1.WINDOWS, 2.WORD
3.EXCEL.**

GJUHA MEME **SHQIPE**


AFTESI DHE PERSHTATJE NE PUNE GRUPI **PO**

Te jetosh dhe punosh me njerz te tjere ku komunikimi eshte baza e grupit.

AFTESI DHE NJOHURI TEKNIKE **PO**
Me computer, materiale dhe makina specifike, etj.

PERVOJA E PUNES **2005-2018 BETON PLUS PEJË**

NYSRET KASTRATI ING. I DIP. I ndertimtarise



Në bazë të nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikën e Kosovës, dhe akteve të brendshme të kompanisë (rregullore, statute) palët e kësaj kontrate në bazë të autorizimeve të tyre si subjekte të së drejtës dhe marrëdhënies së punës, lidhin:

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË PACAKTUAR



Punëdhënësi

Emri i Kompanisë: REA SHPK

Nr. i regjistrimit të biznesit: 811242502

Adresa: KLINE

Përfaqësuesi: AGIM KASTRATI

I/E Punësuar/a

Emri dhe mbiemri: NYSRET KASTRATI

Nr. personal i identifikimit: 2009869207

Vendbanimi: PEJE

Profesioni: *Inxh. Diplomuar i Ndertimit*

Nr. i xhirollogarisë bankare:

Vlefshmëria e kontratës

Data e fillimit të punës: 01.03.2022

Puna provuese: 01.03.2022

Orari dhe vendi i punës

Numri i orëve të punës në javë: 8_orë

Orari i punës: 08- 16

Orët shtesë:

Pushimi gjatë orarit të punës: 1 ore

Vendi i punës: Kosove

Kompensimi i pagës

Paga bruto: 450,00 muaj; _____ orë

Kompensimi për orët shtesë¹:

20 % në orë për kujdestari: €1.44 + 20% = € 1.74

50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave

30 % në orë për punë gjatë natës

50 % në orë për punë gjatë fundjavës

30 % në orë për punë jashtë orarit

¹ Nëse rroga bazë neto është 250 euro, atëherë paga shtesë llogaritet duke marrë parasysh pagën bazë (€ 250) në përpjesëtim me orët e punës në muaj. Në këtë rast, marrim për bazë € 250 + 173,3 (totali i orëve në muaj) dhe si rezultat na del € 1,44 ora. Më pastaj, varësisht nga puna shtesë që realizon punëmarrësi reflektohet në vlerën e orëve të punës.



Pushimi vjetor dhe mjekësor

Pushimi vjetor: 20 ditë

Pushimi mjekësor i rregullt:
deri në njëzet (20) ditë pune

Pushimi mjekësor si rezultat i lëndimit në punë:
dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune

E drejta e kompensimit:

100% të pagës bruto të përcaktuar me këtë kontratë

E drejta e kompensimit:

70% të pagës bruto të përcaktuar me këtë kontratë

Ndërprerja e Kontratës

Me marrëveshje, me pëlqimin e të punësuarit/es dhe punëdhënësit

Sipas fuqisë së ligjit në rastet sikurse parashihen në nenin 67 të Ligjit të Punës apo ligjeve tjera në fuqi në Kosovë

Në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi me paralajmërim prej gjashtëdhjetë (60) ditësh:

- Punëdhënësi ka arsye ekonomike, teknike apo organizative për një veprim të tillë;
- Punëmarrësi nuk është më i aftë të kryej detyrat e punës;
- Punëmarrësi është përgjegjëse për raste të rënda të shkeljes së rregullave të brendshme;
- Punëmarrësi nuk ka përmbushur detyrat e punës në mënyrë të kënaqshme, dhe nuk ka përmirësime edhe pas paralajmërimit të punëdhënësit

Në mënyrë të njëanshme nga i/e punësuar/a:

- me një njoftim me shkrim të dërguar Punëdhënësit prej të paktën tridhjetë (30) ditësh para datës kur synohet të ndërpritet Kontrata.

Zgjidhja e kontesteve

Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, palët pajtohen që fillimisht të provojnë ta zgjidhin me mirëkuptim. Nëse përkundër përkushtimit dhe vullnetit të mirë të dy palëve nuk arrihet marrëveshje, atëherë palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Themelore në Pejë.

Ligji i aplikueshëm

Ligji i Punës Nr. 03/L-212 dhe aktet tjera nën-ligjore të cilat rrjedhin nga aty, si dhe të gjitha ligjet tjera të aplikueshme, që janë të zbatueshme në lidhje me interpretimin e kësaj kontrate.

Kjo kontratë u nënshkrua në 4 kopje autentike, ku secilës palë i mbeten nga dy kopje

Punëdhënësi AGIM KASTRATI

I/E Punësuar NYSRET KASTRATI

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Data e nënshkrimit

Vendi

01/03/2022

PEJE





REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER

ARËSIM S. AVDIJAJ

RR. „MBRETËRESHA TEUTË“ NR. 110, PEJË

LRP-nr.rend:5562/2022

-----VËRTETIM I NËNSHKRIMIT-----

Sot, me datë shtatëmbëdhjetë maj dy mijë e njëzet e dy (17.05.2022), para meje, Arësim S. Avdijaj, Noter, me seli në Pejë, Rruga Mbretëresha Teutë nr.110, u paraqit palët si më poshtë: -----

1. **REA SH.P.K.**, me seli në Klinë, me numer unik identifikues 811242502, me numer te biznesit 70525569, dhe numer fiskal 600181135, përfaqësuar nga pronari z. Agim (Brahim) Kastrati, i lindur në Vërmicë, më 25.08.1966, me zotësi të plotë juridike dhe të veprimit, me vendbanim në rrugën Konferenca e Bujanit, nr.203, në Pejë, shtetas i Kosovës, identitetin e të cilit e kam verifikuar me anë të Letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me numër personal 1003039184, lëshuar nga MPB-RKS me datën 29.01.2019, me vlefshmëri deri me datën 28.01.2029, dhe-----
2. **Nysret (Hazir) Kastrati**, i lindur në Pejë, me 10.08.1977, me zotësi të plotë juridike dhe të veprimit, me vendbanim në rrugën Afrim Gjuraç, nr.5, në Pejë, i identifikuar përmes Letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me numër personal 2009869207, lëshuar me datë 06.02.2019, i vlefshmëri deri më 05.02.2029,-----

të cilët me anë të këtij akti noterial kërkuan vërtetimin e Nënshkrimit. -----

Andaj, Noteri bazuar në Ligjin për Noterinë, vërteton që palët e përshkruara si më lartë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë personalisht e kanë nënshkruar këtë dokument në një fletë me tekst në të dy anët në zyrën e noterit, sot me datë shtatëmbëdhjetë maj dy mijë e njëzet e dy (17.05.2022).-----

Bazuar në Ligjin mbi Noterinë, Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e këtij dokumenti, përkatësisht noteri vërteton vetëm nënshkrimin e vënë në këtë dokument nga palët e përshkruara si më lartë, prandaj të gjitha përgjegjësit në lidhje me përmbajtjen e këtij dokumenti i bartin vetë nënshkruessite këtij dokumenti -----

Palët e lartpërmendurjanëmadhorme zotësi të plotë juridikë dhe të veprimit, te cilate nënshkruan këtë dokument me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.-----

Pasi palët paguan tarifën në vlerë prej 12€+2.16€TVSH-ja=14.16€, ashtu siç përcaktohet në Udhëzimin Administrativ nr. 02/2012 për Tarifën e Përkohshme Noteriale, Noteri e nënshkroi dhe vërtetoi këtë akt noterial në tri kopje kopje identike secila kopje me nga një fletë me tekst në të dy anët. -----







MENAXHERI I PROJEKTTIT

Per projektin :Njërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut

Firma REA SH.P.K. me NRB 811242502 dhe me adrese ne Rr Lidhja e Pejës, Klinë e cakton për menaxher të projektit, në projektin e sipërluar nga Komuna e Gjakovës

AsfaltimNjërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut

me Nr te projektimit :632-23-2174-S-2-1, Inxhinjeri i ndërtimzans z.Nysret Kasirazi
z.Nysret Kasirazi do ta bejë menaxhimin e projektit të lartëcekur deri ne përfundim.



- Për ing. e punishtes pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues sqaron se kjo pikë është keqkuptuar nga operatorët ekonomik sepse Autoriteti kontraktues te kriteri nën a): **Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si ne vijim a.) Një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë -drejtimi konstruktiv (menaxher i kontratës dhe projektit në teren) b.) Një inxhinier i diplomuar apo master i komunikacionit c.) Një gjeodet i licensuar**
Ka nënkuptuar një inxhinjer të vetëm i cili do të jetë menaxher i kontratës dhe projektit në teren dhe këtë pjesë e mbulon marrëveshja për menaxherin e projektit/kontratës
- Për Inxhinjerin e komunikacionit, pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues në FDT nuk ka kërkuar listën e ATK, por vetëm kontratën e punës dhe kjo i plotëson kërkesat e AK;

- Për inxhinjerin e gjeodezisë, Jetmir Avdijaj, pretendimi juaj është i pabazuar sepse për të njëjtin OË “REA” ka prezantuar kontratën, diplomën dhe licencën:

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2,pikat2.1 dhe 2.2,dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 I shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,më dt.01.12.2010,Punëdhënësi dhe I Punësuar,i subjektit të marrëdhënies juridike të punës,lidhin:

REA SH.P.K

KONTRATE PUNE PER KOHE TE PACAKTUAR

Neni 1

Me këtë Kontratë: "REA" sh.p.k. ,me seli në rr.Lidhja e Pejes, KK-Klinë,me Nr. të Biznesit 811242502, të cilën e përfaqëson: ztr. Rinor Kastrati. Lidhë kontratë pune me:Jelmir Avdiaj, të cilin në bazë të autorizimit LRP.Nr.5037/2021, dt.14.07.2021 vërtetuar tek Noter Bedri Godanci me seli në Klinë e përfaqëson Valmir Avdiaj
Nr. personal:1007621767 kualifikimi:INGJINJER I GJEODEZIS,adresa e të punësuarit/es:PRISHTINE.

Neni 2

I punësuar do të kryej këto detyra të punës: emertimi i punës:Ingjinjer i angazhuar per projekte.

Neni 3

I punësuar do të kryejë punët në: (vendi ku do të kryhet puna),Në vendpunishte te kompanis.

Neni 4

I punësuar themelon marrëdhënie pune,në:

1.Kohë të pacaktuar,duke filluar nga:03.01.2022

Orari i punës është prej orës:08:00 deri ne ora: 16:00

Neni 5

I punësuar është I detyruar të fillojë punën,më: (data,muaji dhe viti),03.01.2022.

Në rast se I punësuar nuk e fillon punën në ditën e caktuar sipas kësaj Kontrate të Punës,do të konsiderohet se nuk ka themeluar marrëdhënie pune,përveq nëse është penguar të filloj punën për shkaqe të arsyeshme.

Neni 6

Puna provuese e të punësuarit zgjatë deri më:10.07.2022.Gjate periudhës provuese të punës,punëdhënësi dhe I punësuar,i mund ta ndërpresin marrëdhënien e punës,me njoftim paraprak prej (7) ditësh.

Neni 7

I punësuar themelon marrëdhënie pune me orar të plotë,I cili gjatë ditës është:8 orë,ndërsa orët e punës gjatë javës janë: 40 orë.

Neni 8

Të punësuarit I caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin,në lartësi prej 170 euro,së paku një herë në muaj,e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale.

Neni 9

I punësuar ka të drejtë ne pagë shtesë në përqindje të pagës baze:

1. 20% në orë për kujdestari;
2. 30% në orë për punë gjatë natës;
3. 30% në orë për punë jashtë orarit;
4. 50% në orë për punë gjatë ditëve të festive dhe,
5. 50% në orë për punë gjatë fundjavës.

Neni 10

I punësuar ka të drejtë në kompensim të pagës pa u angazhuar në punë, në rastet si në vijim:

1. gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet;
2. gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor;
3. gjatë aftësisimit dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar dhe;
4. gjatë ushtrimit të funksionëve publike për të cilat nuk paguhet.

Neni 11

I punësuar ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor të pagës bazë,prej:

1. 100% në rast të shfrytëzimit të pushimit mjekësor të rregullt,mbi bazën deri në 20 ditë pune brenda I viti;
2. 70% në rast të shfrytëzimit të pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale ,e cila ndërlihdhet me kryerjen e punëve dhe të sherbimëve për punëdhënësin,në kohëzgjatje prej 10 deri në 90 ditë pune.

Neni 12

I punësuar ka të drejtë në kompensim të shpenzimeve gjatë kohës së kaluar në udhëtim zyrtar jashtë vendit,në lartësi prej:300 Euro.



Handwritten signature



Neni 13

I punësuarit ka të drejtë në pushim dhe atë:

1. Pushim gjatë ditës së punës në kohëzgjatje prej së paku 30 minutash, në përputhje me organizimin e orarit të punës së punëdhënësit;
2. Pushim ditor në kohëzgjatje prej së paku dymbëdhjetë (12) orë pandërprerë, midis (2) ditëve të njëpasnjeshme të punës;
3. Pushim javor në kohëzgjatje prej njëzetkatër (24) orë pandërprerë;
4. Pushim vjetor në kohëzgjatje së paku (4) javë - (vlen të theksohet se: për qdo punëtor që I ka mbi 5 vite stazh pune në atë ndërmarrje ka të drejtë: (+ 1 ditë shtese në pushim vjetor);
5. Nëna me fëmijë deri në 3 vjeq, prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor shtesë edhe për (2) ditë të tjera.

Neni 14

I punësuarit, I cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune ose I cili nuk ka ndërprerje më tepër se (5) ditë pune, ka të drejtë në shfrytëzimit të pushimit vjetor pas (6) muajve të punës së pandërprerë.

Neni 15

I punësuarit ka të drejtë së paku një ditë e gjysmë (1.5) të pushimit, për qdo muaj kalendarik të kaluar në punë, nëse

1. Në vitin kalendarik në të cilin për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune nuk I ka gjashtë (6) muaj të punës së pandërprerë.
2. Në vitin kalendarik nuk e ka fituar të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Neni 16

I punësuarit është përgjegjës për kompensimin e dëmit për punën ose në lidhje me punën, nëse me qëllim ose nga pakujdesia I ka shkaktuar dëm punëdhënësit.

I punësuarit është përgjegjës edhe për kompensimin e dëmit, nëse me fajin e tij I ka shkaktuar dëm palës së tretë, dëm për të cilin punëdhënësi e ka kompensuar.

Neni 17

Të punësuarit I ndërprehet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
2. I punësuarit nuk është më I aftë të kryejë detyrat e punës;
3. në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit;
4. për shkak të mospërbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, dhe
5. për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar me Ligjin e Punës

Neni 18

Punëdhënësi obligohet të sigurojë dhe të zbatojë mjetet dhe masat e mbrojtjes në punë, sipas legjislacionit në fuqi. I punësuarit është i detyruar t'u përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

Neni 19

Punëdhënësi obligohet t'i paguajë kontributet për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat e tjera të përcaktuara me Ligj.

Neni 20

Punëdhënësi dhe i punësuarit i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e caktuara me Ligj, me Kontratë Kolektive dhe me këtë Kontratë.

Neni 21

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj Kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Komunale.

Neni 22

Secila palë mund ta shkëpus këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj dhe me Kontratë Kolektive.

Neni 23

Në asnjë rast, dispozitat e kësaj Kontrate nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësit, se dispozitat e Ligjit të Punës ose të Kontratës Kolektive, për sa u përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës. Për të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë Kontratë, zbatohen drejt për drejt dispozitat e Ligjit të Punës dhe të Kontratës Kolektive.

Neni 24

Pas njohimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua më datën: 03.01.2022, në: Klinë, në: 4 (katër) kopje autentike, nga të cilat secilës palë i mbetën nga dy kopje.

Punëdhënësi:

REA SHPK - I Autorizuar Rr. Rina Kastrioti



I Punësuarit: Jetmir Avdiaj, të cilin e përfaqëson Valmir Avdiaj si I autorizuar

(Signature)



Republika e Kosovës
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

LRP.Nr. 7872/2022

-----Vërtetim nënshkrimi-----

Sot, më date **17.06.2022** (shtatëmbëdhjetë qershor dymijë e njëzet e dy) para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli në Lipjan „Rruga” Lidhja e Prizrenit” p.n , vërteton se:-----

Nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur “Kontratë pune për kohë të pacaktuar”, është vënë nga:-----

1. Z.Valmir Avdiaj nga i ati Rexhep, i lindur në F.Llapçevë-Malishevë më dt.**25.07.1986** (njëzet e pesë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) , me vendbanim në F.Llapçevë-Malishevë, shtetas i R.Kosovës, identiteti i të cilit konstatohet nga Letërnjoftimi me nr. Personal **1172973007**, i lëshuar nga MBP-Prishtinë, më 10.03.2015,valid gjerë me 09.03.2025, madhor me zotësi të plotë veprimi.(Përfaqësues i autorizuar i Jetmir Avdiaj në bazë të autorizimit LRP.Nr.5037/2021, dt.14.07.2021 i vërtetuar tek Noter Bedri Godanci me seli në Klinë.).-----

2. Z.Rinor Kastrati, nga i ati Agim, lindur në Altotting më dt.**26.11.1997** (njëzet e gjashtë nëntor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë),me vendbanim në Pejë, shtetas i R.Kosovës, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimit me nr. Personal **1175113742**, i lëshuar nga MBP-Prishtinë, më 16.01.2020,valid deri me 15.01.2025, madhor me zotësi të plotë veprimi (Përfaqësues i “**REA**” sh.p.k.)-----


Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit të përpiluar jashtë zyrës së tij , noteri vetem vërteton nënshkrimin e palës të vënë në praninë e tij dhe në zyrën e tij. -----


Ky akt lëshohet en brevet. Tarifa është paguar sipas UA mbi Tarifat e përkohshme noteriale për çdo nënshkrim 1€ = 2 x 2 nënshkrime që në total për dy nënshkrime kap shumën prej 4€ +1.50€ për vendosjen e vijaletit të vulës (neni 41.6 TPN) = 5.50€ +18% TVSH= 6.49€ (gjashtë euro e 49/100).-----

Veprimi i noterizimit u krye në Lipjan, në selinë e Noterit Zyfer Aliu në adresën e lartshënuar.-----

NOTER

Zyfer Aliu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

me autoritetin e tij ligjor,
me rekomandimin e
Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

i jep Z.

Jelmir Reshepi Avdiqaj

lindur në Llapçevë, Kosovë, më 16.07.1984
me Nr. të diplomës BACHELOR: 230

Diplomë MASTER PROFESIONAL
në Inxhinieri GJEODEZI

pas përfundimit me sukses të studimeve universitare të ciklit të dytë
me kohë të plotë në programin mësimor parashikuar për këtë diplomë.

Data e lëshimit të diplomës: 05.06.2017
Data e mbrojtjes së diplomës: 28.03.2017
Numër diplome: MP-439
Numër amze: PO443G020052

DEKANI:

Prof. Asoc. **Gëzim HASKO**



REKTORI:

Prof. Dr. **Andrea MALIQARI**

14



Republika e Kosovës
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

Akt en brevet.nr.rend.636/2020

VËRTETIM KOPJE nga Origjinali

Sot më date 28.01.2020 (njezet e tetë janar dymijë e njëzet) në zyrën e noterit Zyfer Aliu në Lipjan,Rr."Lidhja e Prizrenit p.n.u paraqit:-----

1. **Z.Jetmir Avdiaj** nga i ati Rexhep, i lindur në F.Llapçevë më datë 16.07.1984 (gjashtëmbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër),me vendbanim ne F.Llugaxhi-Lipjan, shtetas i Republikës së Kosovës,bartës i patentë shoferi me nr. Personal 1007621767 të lëshuar nga MPB-Prishtinë,më dt.24.03.2009 madhor me zotësi të plotë veprimi -----

I lartë përmenduri ka kërkuar nga Noteri:-----

Vërtetimin e dokumentit të sjellur në zyrën e noterit, dokumenti i quajtur "Diplomë MASTER PROFESIONAL në Inxhinieri GJEODEZI", me nr.MP-439 e dt.05.06.2017 e lëshuar nga Universiteti Politeknik I Tiranës , e lëshuar në emër të **Jetmir Rexhep Avdiaj**.-----

Dokumenti përmban 1 fletë dhe 1 faqe.-----

Dokumentin e percaktuar nga pala si origjinal, e ka sjellë vetë ai dhe të njejtin e tërë me kopjen e vërtetuar. Noteri nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e dokumentit që është sjellur nga pala në zyrën e tij noteri verteton vetem kopjen nga origjinali.-----

Noteri, në kuptim të nenit 46 të LNK vërteton dokumentin kopje nga origjinali, që është sjellur në zyrën noteriale në -----
Lipjan-----

Ky akt lëshohet en bevert, Tarifa është paguar sipas UA mbi tarifat e përkohshme noteriale për çdo fletë nga -----
1€= 1x5=5+18%TVSH=5.90€ (pesë euro 90/100).-----

Lipjan me datën 28.01.2020 (njezet e tetë janar dymijë e njëzet).-----



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



Universiteti i Prishtinës
University of Prishtina

FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE

DIPLOMA

IN BASIC UNIVERSITY STUDIES

JETMIR REXHEP AVDI AJ

BORN IN LLAPÇEVË-MALISHEVË ON 16 JULY 1984

REGISTERED IN THE ACADEMIC YEAR 2005/06

COMPLETED THE BASIC

UNIVERSITY STUDIES IN

SECTION OF GEODESY

ON 29 DECEMBER 2009

AND OBTAINED THE TITLE

BACHELOR OF GEODESY

Average grade of studies 7.45

Diploma examination grade 10

Total 180 credits - ECTS

FAKULTETI I INDEKTMITARISË DHE ARKITEKTURËS



DIPLOMË

E STUDIMEVE THEMELORE UNIVERSITARE

JETMIR REXHEP AVDI AJ

LINDUR NË LLAPÇEVË-MALISHEVË MË 16 KORRIK 1984

REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2005/06

MË 29 DHJETOR 2009 MBAROI STUDIMET

THEMELORE UNIVERSITARE NË

DREJTIMIN I GJEODEZISË

DHE MORI TITULLIN

BAÇELOR I GJEODEZISË

Nota mesatare gjatë studimeve 7.45

Nota e provimit të diplomës 10

Gjithsej 180 pikë - ECTS

PRISHTINË, MË 13 JANAR 2010, NR. 230

Dekani

Prof. Dr. Naser Kabashi

Rektori

Prof. Dr. Milis Rogova



REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

LRP.nr.rend.4887/ 2020

VËRTETIM KOPJE nga Originali

Sot më datën **05.08.2020** (pesë gusht dymijë e njëzet) në zyrën e Noterit Zyfer Aliu në Lipjan,Rr.“Lidhja e Prizrenit” p.n.u paraqit:-----

I. **Z.Jetmir Avdiaj**, nga I ati Rexhep ,i lindur në F.Llapçevë-Malishevë , më **16.07.1984** (gjashtëmbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër),me vendbanim në F.Llapçevë-Malishevë, shtetas i Republikës së Kosovës, bartës i letërnjoftimit me nr.personal **1007621767**, lëshuar nga MPB Prishtinë më dt.24.09.2014 , valid gjerë më 23.09.2024 , madhor , me zotësi të plotë veprimi :-----

I lartë përmenduri ka kërkuar nga Noteri:-----

Vërtetimin e dokumentit të sjellur në zyrën e noterit, dokumenti i quajtur “Diplomë” e studimeve themelore universitare, me nr.230 , e lëshuar nga Universiteti I Prishtinës-Fakulteti I Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës , më dt.13.01.2020 , në emër të Jetmir Rexhep Avdiaj .-----

Dokumenti përmban 1 fletë dhe 1 faqe.-----

Dokumentin e percaktuar nga pala si origjinal, e ka sjellë vetë ai dhe të njejtin e tërë me kopjen e vërtetuar. Noteri nuk mban përgjegjesi për përmbajtjen e dokumentit që është sjellur nga pala në zyrën e tij noteri vërteton vetem kopjen nga origjinali,-----

Noteri, në kuptim të nenit 46 të LNK vërteton dokumentin kopje nga origjinali, që është sjellur në zyrën noteriale në Lipjan-----

Tarifa është paguar sipas UA mbi tarifat e përkohshme noteriale për çdo fletë nga 1€ x 10kopje =10€+ 18% = **11.80€** (njëmbëdhjetë euro e 180/ 100) .-----

Lipjan me datën **05.08.2020** (pesë gusht dymijë e njëzet) .-----





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostorno Planiranje / Ministry of Environment and Spatial
Agjencia Kadastrale e Kosovës
Katastarska Agjencia Kosova / Kosovo Cadastral Agency

Në bazë të nenit 6. të Ligjit për Kadastër Nr. 04/L-013.UA Nr.01/2013
Na osnovu člana 6. Zakona o Katastru Br.04/L-013.AU br.01/2013
Based on the section 6. Law on Cadastre No.04/L-013.A1 no.01/2013

LICENCA

Për kryerjen e matjeve kadastrale
Za vrshenje katastarskih merenja



Në bazë të vendimit të komisionit për Licencim Kategorija- I- nr.L-GJ/771 dt. 27.08.2019
për kryerjen e punëve kadastrale
Na osnovu odluke komisije za licenciranje Kategorija- I -
za obavljanje katastarskih poslova
LICENCOHET GJEODETI:
LICENCIRA SE GEODETA:

JETMIR AVDIJ

Emri dhe mbiemri/Ime i prezime

Numri i Licencës / Broj Licence

Data e dhënies së Licencës / Datum izdavanja Licence

Afati i skadimit të Licencës / Licenca važi do:

Kryetari i komisionit / Predsednik komisije

Bsc. Hasim Pacolli

Prishtinë, Ulpian soliteri P+13 hyr I, ban nr.51

Adresa

93

27.08.2019

25.08.2024

Kryeshefi Ekzekutiv/Izvršni načelnik

Mr. Avni Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

LRP.nr.rend.4885/ 2020

VËRTETIM KOPJE nga Origjinali

Sot më datën **05.08.2020** (pesë gusht dymijë e njëzet) në zyrën e Noterit Zyfer Aliu në Lipjan,Rr.“Lidhja e Prizrenit” p.n.u paraqit:-----

1. Z.Jetmir Avdiaj, nga I ati Rexhep ,i lindur në F.Llapçevë-Malishevë , më **16.07.1984** (gjashtëmbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër),me vendbanim në F.Llapçevë-Malishevë, shtetas i Republikës së Kosovës, bartës i letërnjoftimit me nr.personal **1007621767**, lëshuar nga MPB Prishtinë më dt.24.09.2014 , valid gjerë më **23.09.2024** , madhor , me zotësi të plotë veprimi :-----

I lartë përmenduri ka kërkuar nga Noteri:-----

Vërtetimin e dokumentit të sjellur në zyrën e noterit, dokumenti i quajtur **“Licencë”** për kryerjen e matjeve kadastrale , me nr.93 , lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Agjencia Kadastrale e Kosovës më dt.27.08.2019 , valide gjerë më **25.08.2024** , lëshuar në emër të **Jetmir Avdijaj** .-----

Dokumenti përmban **1 fletë** dhe **1 faqe**.-----

Dokumentin e percaktuar nga pala si origjinal, e ka sjellë vetë ai dhe të njejtin e tërë me kopjen e vërtetuar. Noteri nuk mban përgjegjësi për permbajtjen e dokumentit që është sjellur nga pala në zyrën e tij noteri verteton vetem kopjen nga origjinali,-----

Noteri, në kuptim të nenit 46 të LNK vërteton dokumentin kopje nga origjinali, që është sjellur në zyrën noteriale në Lipjan-----

Tarifa është paguar sipas UA mbi tarifat e përkohshme noteriale për çdo fletë nga **1€ x 10kopje =10€+ 18% = 11.80€** (njëmbëdhjetë euro e 180/ 100) .-----

Lipjan me datën **05.08.2020** (pesë gusht dymijë e njëzet) .-----



- Për të punësuarin me parakontratë, Safet Kastrati, te neni 1 i kontratës dhe tek nënshkrimi është shënuar emri Safet Kastrati, vetëm te neni 3 , është shënuar Driton Sapunxhiu, ku shihet qartë se është gabim teknik, prandaj Autoriteti kontraktues konsideron se pretendimi juaj është i pabazuar;

Pretendimi juaj i tretë gjithashtu nuk qëndron, sepse këtu nuk kemi zhvilluar procedurë me poëtim po procedurë për tenderin ekonomikisht më të favorshëm, dhe në bazë të formulës OE'REA" shpk. ka dalë më i suksesshmi:

Koeficienti:	0.7	0.2	0.1
OPERATORI EKONOMIK	Çmimi	AFATI - DINAMIKA DITE	PERIUDHA GARANTUESE - VITE
Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I., Imer Krasniqi, 20400, MALISHEVË	246,833.38	161	2
Grup i Operatorëve Ekonomik „Benita Company Sh.p.k.; ASFALT GROUP SH.P.K., Gremnik, 32000, Klinë	240,000.00	58	3
Grup i Operatorëve Ekonomik BERISHA COM SH.P.K.; VIZION PLUS SH.P.K., GJAKOVË, 50000, UJEZ	264,643.48	90	3
" REA" SH.P.K., ABEDIN REXHA, 32000, KLINË	230,000.00	29	3
MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Rruga "Abedin Rexha" p.n., 32000, Klinë	251,706.00	150	3
Asfalti SH.P.K., Bellopoje, 30000, BELLOPOJE	217,457.78	44	3

Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM ; Marisa SH.P.K., Gjakovë, 50000, Gjakovë	237,143.49	40	3
--	-------------------	-----------	----------

Operatorët Ekonomik:	PESHA/CMIMIT	PESHA/AFATIT	PESHA/PERIUDHES GRANTUESE	TOTALI I PIKEVE:
Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I., Imer Krasniqi, 20400, MALISHEVË	61.67	3.60	6.67	71.94
Grup i Operatorëve Ekonomik „Benita Company Sh.p.k.; ASFALT GROUP SH.P.K., Gremnik, 32000, Klinë	63.43	10.00	10.00	83.43
Grup i Operatorëve Ekonomik BERISHA COM SH.P.K.; VIZION PLUS SH.P.K., GJAKOVË, 50000, UJEZ	57.52	6.44	10.00	73.96
" REA" SH.P.K., ABEDIN REXHA, 32000, KLINË	66.18	20.00	10.00	96.18
MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Rruga "Abedin Rexha" p.n., 32000, Klinë	60.48	3.87	10.00	74.34
Asfalti SH.P.K., Bellopoje, 30000, BELLOPOJE	70.00	13.18	10.00	93.18
Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM ; Marisa SH.P.K., Gjakovë, 50000, Gjakovë	64.19	14.50	10.00	88.69

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyres së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës